



Zhvendosja e të Drejtave

Rikthimet e Detyruara të Romëve, Ashkalinjëve dhe Egjiptianëve nga Europa Perëndimore drejt Kosovës

Përmbledhje

Komuniteti i Romëve të Kosovës – të njohur botërisht si Romët, Ashkalinjtë dhe Egjiptianët (RAE) – është historikisht më i varfri dhe i nënvleftësuar si ekonomisht ashtu edhe politikisht dhe në aspektin social. Romët janë shënjestruar shpesh nga sulme të dhunshme, të hedhura poshtë nga disa shqipëtarë të Kosovës – grupi më i madh etnik në vend – duke i cilësuar si "bashkëpunëtorë" të popullatës që i përket minoritetit serb. Ndërkohë Ashkalinjtë dhe Egjiptianët shqip-folës janë bërë gjithashtu viktime të sulmeve të motivuara etnikisht. Në vitet e fundit, shumë nga RAE- t janë shpërngulur nga Kosova duke e ulur numrin e tyre nga 200 000 përpara luftës së vitit 1999 në rreth 38 000 në ditët e sotme.

Pak nga të zhvendosurit rikthehen. Të dekurajuar nga varfëria ekstreme, mungesat në aspektin social, diskriminimi i vazhdueshëm, paqëndrueshmëria politike dhe mungesa e ndihmës së përshtatshme për të garantuar që rikthimi i tyre të jetë i qëndrueshëm, vetëm 8160 RAE janë rikthyer në Kosovë me vullnetin e tyre që nga viti 1999. Për më tepër, ritmi i rikthimeve të vullnetshme ndër vite ka qënë i avashtë, me më pak se 500 persona të rikthyer në vitin 2009 dhe diçka më shumë se 200 persona të rikthyer deri tani më 2010– tën.

Por këto të rikthyer vullnetarisht nuk janë të vetmit RAE që kanë marrë drejtimin e rrugës së kthimit për Kosovë. Të shgënjyer së tepërmi nga ritmi i avashtë i rikthimeve të vullnetshme, si edhe nga shqetësimet e politikës vendase mbi azilin dhe emigracionin, disa vende perëndimore – përfshirë edhe Gjermaninë, Zvicrën dhe Suedinë – kanë dëbuar dhe kthyer RAE- t në Kosovë. Duke filluar që nga viti 1999, rreth 51, 000 RAE janë rikthyer pa vullnetin e tyre në Kosovë dhe duket se këto shifra vijnë duke u shtuar. Ndërkohë që nuk ka statistika të sakta, vetëm në Gjermani 12, 000 RAE nga Kosova – përfshirë këtu edhe mbajtësit e një "leje të përkohshme durimi", të dështuarit si kërkues të azilit dhe migrantë të tjerë të parregulltë – llogariten të jenë të rrezikuar nga dëbimi.

Kosova ka nënshkruar marrëveshje me një numër gjithnjë e në rritje të shteteve të Europës me qëllim përlehtësimin e dëbimeve të këtij lloji – megjithëse udhëzimet e Zyrës së Komisionerit të Lartë për Refugjatët pranë OKB- së (UNHCR) u bëjnë thirrje vendeve që të mos dëbojnë Romët serbisht-folës dhe disa etni të tjera të caktuara (si serb ashtu edhe shqiptar) në shtetet ku ato do të ishin në minoritet. UNHCR gjithashtu këmbëngul që Ashkalinjtë dhe Egjiptianët të rikthehen vetëm pasi të skanohen dhe vlerësohen rreziqet e rikthimit, si edhe kjo të ndodhë në një mënyrë të përshkallëzuar, e cila merr parasysh kapacitetet e kufizuara të absorbimit në Kosovë.

Organizata për të Drejtat e Njeriut, Human Rights Watch, beson se përfaqësja aktuale e qeverisë së Kosovës dhe e qeverive të Europës Perëndimore sa i përket rikthimeve të detyruara të RAE- ve është dritëshkurtër dhe rrezikon në këtë mënyrë të drejtat e RAE- ve dhe stabilitetin e Kosovës. Ndërkohë që numri i rikthimeve të detyruara deri në këtë moment që flasim ka qënë relativisht i ulët, marrëveshjet e ripranimit ndërmjet qeverisë së Kosovës dhe vendeve të Europës Perëndimore momentalisht janë në negociata e sipër ose janë tashmë të përfunduara. Mungesa e vlerësimit të drejtë nga ana e qeverisë së Kosovës përpara zbatimit të rikthimeve të detyruara, mbart me vete një rrezik real për shkelje të të drejtave të njeriut, si edhe një krizë në rritje për të dëbuarit, për familjet e tyre si edhe për komunitetin e RAE- ve në tërësi, të cilët mbeten tashmë grupi më i cënueshëm dhe i përndjekur në popullatën e Kosovës.

RAE- t të cilët dëbohen drejt Kosovës përballen me shumë pengesa që lidhen me të drejtat e tyre njerëzore themelore, përfshirë këtu edhe mungesën e informimit mbi dokumentat personale; të qënurit pa shtetësi; apo problem që lidhen me besimin mbi pronën e tyre apo me gjetjen e strehimit; vështirësi që lidhen me aksesin në arsim, shëndetësi, punësim dhe mirëqënie sociale; si edhe ndarjet nga pjesëtarët e familjes. Disa nga të dëbuarit lejnë mbrapa bashkëshorten – tin dhe fëmijët, veçanërisht kur janë të martuar me nënshtetas të huaj dhe kur kanë nacionalitete të ndryshme nga fëmijët e tyre, fakt ky që ndikon në të drejtën e jetës familjare. Shumë të tjerë përballen gjithashtu me mungesën e dokumenteve të identitetit, të cilat janë të domosdoshme për aktivitete të shumta dhe rregjistrime si qytetar apo votues dhe në disa raste mund të ketë si pasojë de- facto pashtetësinë. Shumë nga fëmijët e dëbuar gjithashtu nuk janë në gjendje të marrin pjesë plotësisht në shkollë, sepse ato nuk flasin mjaftueshëm gjuhën shqipe apo serbe dhe hasin probleme me korrikulumet e ndryshme si edhe me njohjen e certifikatës së huaj të arsimit.

Probleme të kësaj natyre nuk janë të rralla për RAE-t e dëbuar drejt Kosovës kundër vullnetit të tyre. Të gjithë qytetarët e Kosovës janë të prekur nga aksesin i kufizuar në

shërbimin shëndetësor, në punësim dhe mirëqënjen sociale. Për më tepër RAE- t të cilët qëndrojnë në Kosovë si edhe të rikthyerit vullnetarisht apo të “nxitur” nga vendet e Europës Perëndimore (të cilët marrin një asistencë të njehershme apo me afat kohor nëse bien dakort për tu larguar me vullnetin e tyre në vend që të dëbohen) përballen me shumë nga këto vështirësi. Sidoqoftë, diskriminimi i vashdueshëm, mospërfshirja sociale dhe mungesa e familjaritetit me sistemin shëndetësor dhe atë arsimor, në të cilin ato po rriten, nënkupton që të dëbuarit RAE ndodhen në gjendjen më të keqe nga të gjithë.

Megjithë këto probleme, qeveritë e Europës Perëndimore duken të vendosura për të vazhduar me rikthimet e detyruara të RAE- ve, gjëndja e vështirë e të cilëve injorohet në përgjithësi si nga ato, ashtu edhe nga donatorët e tjerë ndërkombëtarë. Mosdashja e qeverive të Europës Perëndimore për të ndihmuar të rikthyerit me detyrim mund të lidhet me dëshirën e tyre për të inkurajuar individët e rrezikuar nga dëbimi që të bien dakort për tu larguar vullnetarisht në këmbim të një mënyre për ti ndihmuar financiarisht. Ndërkohë donatorët dy - apo shumëpalësh, të cilët nuk janë të përfshirë në dëbime, mund të tregohen të kujdesshëm që mos të vlerësohen si bashkëfajtor në këtë proces, nëse ato vendosin të marrin pjesë në ndihmën për të rikthyerit me detyrim. Sido që të jetë shpjegimi, momentalisht është vështirë të gjendet ndonjë organizatë ndërkombëtare, lokale apo jo-qeveritare (OJQ) që të ketë programe me qëllim dhënien e ndihmës financiare për RAE- t e rikthyer me detyrim, dhe kjo ja shton barrën me të cilën përballen tashmë komuniteti RAE në përgjithësi, duke mbetur në pozita tepër të cënueshme.

Ndërkohë qeveria e Kosovës, në vend që të insistojë me qëllim që të rikthyerit të kenë kushte të përshtatshme, po i përlehtëson ato në një mënyrë të çrregulltë dhe duke mos ndërmarrë hapat e nevojshëm për integrimin e tyre. Për shëmbull, asaj i mbetet akoma për të plotësuar Strategjinë e saj të vitit 2007 për Riintegrimin e Personave të Repatriuar dhe Planin shtesë të Aksionit të vitit 2008, i cili nënvizon orientimet e politikës për përmirësimin e kushteve të jetesës së RAE- ve, si edhe identifikon nevojat e të rikthyerve me detyrim dhe të rikthyerve në forma të tjera, siç janë strehimi, aksesin në dokumentat personale, në shërbimin shëndetësor, në punësim, në arsim dhe në mirëqënjen sociale. Për më tepër, autoritetet bashkiake mbeten kryesisht të painformuar për ekzistencën e dokumenteve dhe detyrimet e tyre të specifikuar në to.

Në vitet e fundit janë rritur notat kritike nga ana e komunitetit ndërkombëtar sa i përket rikthimeve të detyruara. Për shëmbull, në raportin e tij në vijim të një misioni special në mars të vitit 2009, Komisioneri Thomas Hammarberg nga Këshilli i Europës për të Drejtat e Njeriut, doli në konkluzionin se rithimet e detyruara nga Europa Perëndimore mund të

“destabilizojnë situatën e sigurisë tashmë të brishtë, si edhe të rrisin tensionet etnike,” dhe mund të ndikojë negativisht në situatën me të cilën përballen komunitetet minorene të Kosovës. Ai i bëri thirrje qeverive europiane që të shmangin rikthimet e detyruara të minoriteteve drejt Kosovës dhe i kërkoi atyre që të “rregullojnë” (vënë në rregull) statusin e tyre në vendet pritëse derisa kushtet në Kosovë ti mundësojnë atyre një rikthim të sigurt.

Gjatë një vizite në Kosovë në qershor – korrik të vitit 2008, Walter Kälin, Përfaqësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm për të Drejtat e Njeriut dhe Personat e Zhvendosur Brendshëm pranë OKB– së, gjithashtu konkludoi se anëtarët e komuniteteve minorene të cilët ishin rikthyer forcërisht rrezikoheshin nga zhvendosja e brendshme për shkak të “modelit të përhapjes së diskriminimit të shoqëruar me mungesën e mbështetjes për riintegrim.” Ai i rekomandoi autoriteteve të Kosovës dhe shteteve që aplikojnë rikthime të detyruara drejt Kosovës që “të marrin masa të forta për ti ofruar personave të tillë perspektiva reale riintegrimi,” të shmangin rikthimet e minoriteteve dhe të rregullojnë statusin e tyre në shtetet ku ato banojnë, për aq kohë sa diskriminimi mbetet “i përhapur” dhe kushtet pengojnë rikthimin e sigurtë.

Ndërkohë Sekretari i Përgjithshëm i OKB– së Ban Ki– moon në raportin e tij drejtuar Këshillit të Sigurimit të OKB– së paralajmëroi shtetet e Europës Perëndimore, të cilët forcërisht rikthenin minoritetet kosovare, që rikthime të këtij lloji mund të kenë ndikim negativ në situatën e përgjithshme të sigurisë, mund të dëmtojnë stabilitetin dhe të reduktojnë mundësitë e autoriteteve të Kosovës për të mbështetur rikthimet në përgjithësi. Ban citoi mungesën e vullnetit politik dhe financime të papërshtatshme si arsye kryesore për dështimin e autoriteteve të Kosovës për të ndihmuar të dëbuarit në mënyrë të kënaqshme. UNHCR gjithashtu ka shprehur shqetësim, kryesisht në kontaktet e tyre me qeveritë perëndimore të përfshira.

Deklaratave të këtij lloji u është bërë jehonë në nivel kombëtar në Gjermani, shtet i cili ka rikthyer numrin më të madh të minoriteteve në Kosovë. Gjatë një debati në Bundestag– un e Gjermanisë (dhoma e ulët e Parlamentit), në qershor të vitit 2010, e iniciuar nga E Majta (Die Linke) dhe nga partitë opozitare të gjelbërta, përfaqësuesit e UNICEF– it në Gjermani, ProAsylum (një OJQ), kishat e Gjermanisë dhe Christian Schwartz-Schilling (një ish–Përfaqësues i Lartë i BE– së në Bosnje dhe Hercegovinë) argumentuan se diskriminimi i përhapur dhe përndjekja e RAE– ve në Kosovë nëse do të vazhdojë të ashpësohet nga një rritje e konsiderueshme e numrit të rikthimeve të detyruara, do të sillte si pasojë përjashtimin ose ndrydhjen e tyre. Në përgjigjen e tyre zyrtarët që përfaqësonin autoritetet e Land– ve të Gjermanisë argumentuan se deri më tani vetën një numër relativisht i vogël i RAE– ve janë

rikthyer në Kosovë dhe se rikthimet janë udhëhequr nga një "mënyrë e përgjegjshme dhe me fazë" duke nënvizuar se shumë prej RAE-ve të repatriuar "nuk ishin të mirë-integruar në Gjermani, si nga ana gjuhësore ashtu edhe ekonomikisht."

Bashkimi Europian duhet t'i japë prioritet garancive që Kosova jo vetëm të jetojë në stabilitet e në paqe, por edhe të respektojë të drejtat e banorëve të saj. Me qëllim që shpërnguljet të bëhen në një mënyrë konsistente me këtë objektiv, BE-ja dhe qeveritë e tjera të Europës Perëndimore duhet të përqëndrojnë përpjekjet e tyre në krijimin e kushteve për një rikthim të qëndrueshëm të RAE-ve në Kosovë dhe të angazhohen me burime financiare e mjete të tjera, si edhe të kenë vullnetin politik për të përmirësuar të drejtat e RAE-ve në Kosovë, në vend që të merren me dëbime në mungesë të kushteve të tilla.

Si hap i parë urgjent, të gjithë qeveritë e Europës Perëndimore duhet të angazhohen me shtyrjen e rikthimeve të detyruara drejt Kosovës, në varësi të përmirësimit të kushteve të pritjes. Çdo rikthim duhet të zbatohet në përputhje me udhëzimet e UNHCR-së.

Donatorët duhet t'u japin ndihmë RAE-ve të rikthyer në Kosovë dhe RAE-ve të zhvendosur në Kosovë dhe të rikthyer në zonat e tyre të banimit, pavarësisht nëse rikthimi është i organizuar, spontan apo i pavullnetsëm. Ndihma duhet të konsistojë si ndihmë gjithëpërfshirëse për komunitetet pritëse me qëllim që të përlehtësohet riintegrimi dhe të shmangen rikthimet që mund të përkeqësojnë kushtet e atyre që tashmë ndodhen atje të pranishëm.

Autoritetet e Kosovës gjithashtu duhet të bëjnë më tepër për të ndihmuar popullatën e tyre RAE, përfshirë këtu edhe ato të cilët janë rikthyer forcërisht, të vënë në dizpozicion burime financiare dhe mjete të tjera si edhe të kenë vullnetin e nevojshëm politik për të zbatuar strategjinë e integritit të RAE-ve në nivel bashkiak. Ato duhet të këmbëngulin që rikthimet të shoqërohen me kushte të përshtatshme, si edhe të përfshihen me nota më kritike në procesin e ripranimit, përfshirë këtu edhe analizën e vlerësimit të rreziqeve individuale përpara se të miratojnë rikthimet e detyruara apo të llojeve të tjera, si edhe të bllokojnë rikthimet që do të rezultojnë në keqtrajtim.

Rekomandimet Kryesore

Drejtuar Qeverisë së Kosovës

- Ti kërkojë shteteve të Europës Perëndimore që të aplikojnë një shtyrje të përkohshme sa i përket rikthimeve të detyruara drejt Kosovës, derisa të mundësohet që kushtet në pritje të jenë të qëndrueshme.
- Të marrë masat e përshtatshme buxhetore për të ndihmuar RAE- t e rikthyer forcërisht si në nivelin qendror ashtu edhe në atë bashkiak.
- Të krijojë, me ndihmën financiare të vënë në dispozicion nga donatorët dy – dhe shumëpalësh, një fond të besuar si shtesë mbi burimet financiare, për financimin e përshtatshëm të ndihmës në pritje (përfshirë strehimin, shkollimin, kujdesin për shëndetin, mirëqënjen sociale si edhe masat që duhen marrë për mundësimin e punësimit) për të rikthyerit me detyrim.
- Të garantojë që të gjithë të rikthyerit potencial të shoqërohen individualisht përpara se të rikthehen, në përputhje me udhëzimet e Komisionerit të Lartë për Refugjatët pranë OKB- së (UNHCR).
- Të zbatojë urgjentisht Strategjinë e vitit 2007 për Rintegrimin e Personave të Repatriuar.

Drejtuar Autoriteteve Bashkiake të Kosovës

- Të konsultohen me përfaqësuesit e RAE- ve dhe të ndihmojnë të rikthyerit me detyrim RAE si edhe të rikthyerit e tjerë në regjistrimin civil, legalizimin dhe keqkuptimet mbi pronën, përfshirjen në mirëqënjen sociale dhe regjistrimet nëpër shkolla.

Drejtuar Qeverive Europiane të Përfshira në Dëbime drejt Kosovës (përfshirë këtu Gjermaninë, Zvicrën, Suedinë, Danimarkën, Norvegjinë, Hollandën, Belgjikën, Austrinë, Mbretërinë e Bashkuar, Francën, Italinë, Luksemburgun dhe të tjerë)

- Të ndalojnë përkohësisht dëbimet e RAE- ve të Kosovës, derisa kushtet në pritje për një rikthim të sigurt dhe dinjitoz të jenë të përshtatshme.
- Të garantojnë që çdo rikthim në Kosovë të zbatohet në përputhje me udhëzimet e Komisionerit të Lartë për Refugjatët pranë OKB- së (UNHCR).
- Të ndihmojë qeverinë e Kosovës që të mbulojë ndihmën thelbësore për të rikthyerit me detyrim RAE.

Drejtuar Aktorëve Ndërkombëtarë në Kosovë (përfshirë këtu edhe OKB– në, Komisionerin e Lartë për Refugjatët pranë OKB- së (UNHCR), BE– në dhe OSBE– në)

- Të koordinojnë agjensitë, donatorët ndërkombëtarë dhe autoritetet e Kosovës me qëllim që të garantohet që në projektet e ardhshme të ndihmës për komunitetet RAE të përfshihen edhe të dëbuarit me detyrim.

Drejtuar Donatorëve Dy – dhe Shumëpalësh (përfshirë këtu edhe BE– në, OKB– në, Bankën Botërore si edhe agjensitë e shteteve të Europës Perëndimore për zhvillim)

- Të mbështesin programet që kanë për qëllim përmirësimin e kushteve të përshtatshme të pritjes për të dëbuarit me detyrim.
- Të kanalizojnë ndihmën nëpërmjet një fondi të besuar në bashkëpunim të ngushtë me autoritetet e Kosovës, me qëllim që të garantohet që fondet të përdoren në mënyrë transparente dhe efikase.